

VENDIM
Nr.67, datë 11.2.1997

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.445, DATË 13.12.1991 “PËR VËRTETIMIN E KOHËS SË VUAJTJES SË DËNIMIT ADMINISTRATIV NGA ISH-TË INTERNUARIT E TË DËBUARIT PËR ÇËSHTJE POLITIKE, KUR MUNGOJNË DOKUMENTET ZYRTARE”

Me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.445, datë 13.12.1991 pika 3 të bëhet si vijon:

“Qenia i internuar ose i dëbuar mund të vërtetohet në rrugë administrative nga komisioni përkatës deri në datën 30.6.1997”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi